



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
Up1 Nr. 03-120
15.04.2022
SH k u p

Bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dh nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 101 nga i njëjti Ligj, pika 5 i Zdhëzuesit për përcaktimin e afatit për të vepruar sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-6039/1 nga 20.10.2015, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1164/1 nga 23.03.2022 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1682/9 nga 15.04.2022, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, në seancën e 15-të e mbajtur më 15.04.2022, miratoi si në vijim:

Vendim
për marrjen e masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT NJOFTOHET Shoqëria tregtare transmetuese (SHTR) Televizion SITELL SHPKPV Shkup, për shkelje të nenit 101 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (LSHMAAV), ku në kuadër të shërbimeve televizive programore më datë 21, 22 dhe 23 shkurt 2022., janë transmetuar spote tele-shopping me shtesa ushqimore „Bronho protekt“ („Broncho protect“), prodhim i operatorit të ushqimit „Natyra terapi“ („Natura therapy“), në të cilën paraqitet si vizualisht dhe në ekran Biljana Debarlieva, prezantuese e rregullt e lajmeve në SHTR Kanal 5 SHPKPV Shkup.

Shkelja nga paragrafi 1 i kësaj pike, është specifikuar dhe në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1164/1 nga 23.03.2022., e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

1. OBLIGOHET SHTR Televizioni SITELL SHPKPV Shkup, në afat kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV.

2. Pas skadimit të afatit i përcaktuar në pikën 2 të këtij Vendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Vendimi, a ka vepruar sipas Vendimit.

3. Ky Vendim është përfundimtar, dhe si ditë e miratimit të tij është dita e vërtetimit në arkivën e Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Agjenci).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe dhënësve të shërbimeve audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga Ligji ekzistues, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera të marra nga Agjencia.

Në pajtueshmëri me nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë solli masë – vendim për vërejtje publike në pajtueshmëri me këtë Ligji, në rast të shkeljes së dispozitave nga LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuar nga i njëjti Ligj, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtueshmëri me nenin 101 nga LSHMAAV, në reklama dhe tele-shopping nuk lejohet të tregohet, si vizualisht ashtu dhe në ekran, fytyrat që rregullisht prezantojnë lajme dhe emisione aktuale informative.

Në kuadër të kompetencave të saja ligjore, Agjencia përmes Sektorit për punë programore, më 22 mars 2022., ka kryer një mbikëqyrje të jashtëzakonshme programore (monitorim) ndaj shërbimit programor televiziv të SHTR Televizion SITELL SHPKPV Shkup, të transmetuara më datë 21, 22 dhe 23 shkurt 2022., në nivel shtetëror, ku konstatoi shkelje të nenit 101 nga LSHMAAV. Mbikëqyrje e jashtëzakonshme është realizuar pas njoftimit nga Agjencia për ushqim dhe veterinar (AUV) për komunikime audiovizuale komerciale të paligjshme për shtesa ushqimore, dhe në kuadër të Memorandumit për bashkëpunim ndërmjet ASHMA-së dhe AUV-së, lidhur më 14.04.2021.

Shkelja ishte bërë më datën 21, 22 dhe 23 shkurt 2022., me transmetim të spotit tele-shopping për shtesa ushqimore „Bronho proekt“ („Broncho protect“), prodhim i operatorit me ushqim „Natura terapi“ („Natura therapy“), në të cilën dhe vizualisht dhe në ekran paraqitet Biljana Debarlieva, prezantuese e rregullt e lajmeve në SHTR Kanal 5 SHPKPV Shkup.

Shkelja nga pika 1 e këtij Vendimi, është e specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1164/1 nga 23.03.2022 ., e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi 3 nga LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKPV Shkup më 24.03.2022., dërgoi Shkresë i yni Up1 nr.10-1164/2 nga 24.03.2022., ku i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1164/1 nga 23.03.2022., me qëllim në afat kohor prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të paraqesë sqarim me shkrim për shkelje të dispozitave nga LSHMAAV.Në afatin e paraparë, SHTR Televizion SITEL SHPKPV Shkup nuk u deklarua për shkeljen e dispozitave nga Ligji. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.04.2022 ., e rishikoi lëndën e Raportit me shkrim dhe konkludoi ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKPV Shkup të shqiptohet masë- vërejtje publike.

Në përputhje nga sa u tha më sipër, bazuar në nenin 18 paragrafi 1 alinea 20 dhe nenin 23 paragrafi 1 alinea 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 101 nga i njëjti Ligj, pika 5 nga Udhëzuesi për përcaktimin e afatit për të vepruar sipas vendimit të Agjencisë për marrjen e masës, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1164/1 nga 23.03.2022. dhe Konkluzionin ark.nr.02-1682/9 nga 15.04.2022., për konstatim të shkeljes të dispozitave nga LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij Vendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 15.04.2022 .,solli Vendim për vërejtje publike ndaj SHTR Televizion SITEL SHPKPV Shkup dhe obligohet, në afat kohor prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Vendimit, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit që parashihet në pikën 2 të këtij Vendim, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyruar, i përmendur në pikën 1 të këtij Vendimi, ka vepruar sipas Vendimit.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër tij transmetuesi ka të drejtë padie për kontest administrativ pranë gjykatës kompetente. Padi për kontest administrativ paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të Vendimit.

Bazuar në sa më sipër u tha, u soll vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuele,**

Kryetar i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI d.v

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi transmetuesi mund të ngrejë padi për kontest administrativ pranë gjykatës kompetente.Padia për kontest administrativ paraqitet në afat kohor prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1164/1 nga 23.03.2022.

Dorëzuar tek:

- SHTR Televizion SITEL SHPKPV Shkup;
- Administrator i SHTR Televizion SITEL SHPKPV Shkup;
- Personi përgjegjës i programit në SHTR Televizion SITEL SHPKPV Shkup;
- Sektori për çështje juridike dhe prokurim publik;
- Sektori për çështje programore; dhe
- Personat e autorizuar për udhëheqjen e regjistrit Up1.